



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/15/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga K.B ndaj gjyqtares L.B, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 22.07.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga K.B ndaj gjyqtares L.B për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Pala K.B me datë 27.06.2024 përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka paraqitur kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares L.B, me pretendimet për gjykim të njëanshëm me konflikt të interesit C.nr.3221/16.

Parashtruesi i ankesës në ankesën e tij ka deklaruar se pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë është shqyrtuar kontesti nga marrëdhënia e punës së paditëses Kolegji Evropian “Juridica” kundër të paditurit – kundër paditësit K.B, me kontest mos përmbushje e kontratës dhe kthim i të hollave. Sipas parashtruesit të ankuesit, gjyqtarja K.B dhe av. T.B, avokate nga Prishtina, përfaqësuese e të e paditësit, janë të afërme, miq dhe të njohshme nga familja, informatë kjo e cila sipas parashtruesit të ankesës është dhënë nga Prof. Ass.Dr. F.L, i cili ka vdekur në Mars të vitit 2019. Përveç kësaj, parashtruesi i ankesës ka deklaruar se ka kërkuar nga gjyqtarja me vërejtje lidhur me sekretaren juridike S.C, duke deklaruar se e njëjta nuk mund të mbajë procesverbal për shkak të konfliktit të interesit, sepse e njëjta është studente e Kolegjit Evropian “Juridica” në Prishtinë.

Tutje ka deklaruar se Ekspertja financiare M.M e cila ka dhënë mendim dhe konstatim në të cilin nuk ka marrë pjesë dhe këtë eksperte nuk e njeh dhe nuk e ka parë asnjëherë në Pallatin e Drejtësisë duke dhënë mendim dhe konstatim nga dija de profili i saj e aq më pak në rastin e tij. Tutje ka deklaruar se konsideron se vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë nuk ka kurrfarë arsytimi për refuzimin e kundërpadisë si të jashtë afatshme dhe si i tillë është aktgjykim me dy standarde dhe kontradiktor.

Ndër të tjerash ka deklaruar se gjyqtarja L.B në shqyrtimin gjyqësor të datës 27.10.2020 e ka fyer rëndë me fjalë “marre për ty” si njeri akademik dhe profesor me titull akademik dhe shkencor, dhe e gjitha kjo me nxitjen e avokates T.B.

Ndër të tjera ka përmendur vërejtjet e gjyqtarës së çështjes në procesverbalet gjyqësore në raport me të autorizuarën e paditësit, si ajo e datës 21.01.2020,26.07.2021,07.12.2021 dhe 20.04.2022, meqë rast me këtë raste gjykata i ka rrezikuar “Të drejtën për Gjykim të drejtë dhe të paanshëm”, pasi që gjatë çdo shqyrtimi gjyqësor sipas parashtruesit të ankesës ka munduar barazia para ligjit dhe siguria juridike për një gjykim të drejtë dhe pa fyerje, ku fyerjen e ka nxitur avokatja e palës paditëse, e cila sipas parashtruesit e ka godit rëndë ehe moralisht edhe materialisht me dëme në vlerë mbi 50.000€, shëndetin, familjen, shoqërinë e kolegët.

Po ashtu, ka deklaruar se pas mbajtjes së seancës kryesore, duke pritur procesverbalin në korridor, e autorizuar me autorizim kundërligjor av. T.B e ka nënçmuar duke thënë “Kur të kryhet ky gjykim kam me ba dasëm”, ku sipas parashtruesit të ankesës është ndier shumë keq dhe asnjëherë më parë nuk ka përjetuar fyerje me të rëndë në vlerat njerëzore dhe kjo fyerje i ka shkaktuar shumë probleme në mesin familjar dhe shoqëror.

Në fund ka deklaruar se që nga seanca përgatitore e datës 22.01.2020 e deri te seanca kryesore me datë 20.04.2022 të gjitha i konsideron seanca koti për shkak të autorizimit të kundërligjshëm i dhënë nga autorizim dhënësi me konflikt interesi, ashtu që me dhënien e fjalës përfundimtare ndaj gjykatëses – shumë keq ka reaguuar av. T.B duke ju drejtuar gjykatëses me këto fjalë “ Ti gjykatës të paditurin – kundër paditësin po e mëson si me u mbrojt dhe cilat dokumente me ti sjell në gjykatë, të cilin procesverbal e autorizuar as sot as dje as pardje nuk e ka nënshkruar.

Në lidhje me ankesën e parashtruar, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se në këtë gjykatë është zhvilluar procedura gjyqësore në mes të paditësit - kundër të paditurit Kolegji Evropian “Juridica” me seli në Prishtinë të cilin e përfaqëson T.B avokate në Prishtinë dhe të paditurit – kundër paditësit K.B, nga Prishtina, sipas padisë për kthimin e të hollave për shkak të mos përmbushjes së kontratës dhe kundërpadisë për pagimin e pagave të paguara.

Sipas gjyqtarës, me datë 11.05.2022 ka nxjerr Aktgjykimin C.nr.3221/2016 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit - kundër të paditurit dhe e ka detyruar të paditurin – kundër paditësin që paditësit - kundër të paditurit t’ia kompensojë shumën prej 4.300.00 €, e me kamatë ligjore. Ndërsa, e ka refuzuar të pabazuar kundërpadinë e të paditurit-kundër paditësit, me të cilën ka kërkuar të detyrohet paditësi – kundër i padituri që të paditurit-kundër paditësit t’ia paguaj pagat e papaguara në shumë prej 13,632.00 €. Ndaj këtij aktgjykimi i padituri – kundër paditësi ka ushtruar ankesë.

Sipas gjyqtarës, lënda në fjalë sipas aktit përcjellës të datës 20.07.2022 është dorëzuar në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë dhe është në pritje për vendosje lidhur me ankesën e ushtruar ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se nuk qëndron pretendimi i paraqitur nga parashtruesi se e njëjta e njeh avokaten T.B pasi që sipas saj të njëjtën nuk e ka të afërme, të njëjtën e ka takuar pasi që ka filluar punën si gjyqtare dhe të njëjtën e ka takuar vetëm atëherë kur ka qenë e ftuar në seanca gjyqësore si përfaqësuese e palëve në procedurë, ndërsa asnjëherë më parë nuk ka dëgjuar për të njëjtën. Po ashtu ka deklaruar se nuk e ka njohur as të ndjerin F.L, për të cilin ankuesi pretendon se e ka njoftuar lidhur me këtë fakt.

Tutje gjyqtarja ka deklaruar se po ashtu nuk qëndrojnë as pretendimet për konflikt interesi në lidhje me sekretaren juridike, kjo për faktin se në asnjë procesverbal (e as në ato të cilat i janë bashkangjitur ankesës) ankuesi nuk ka parashtruar vërejtje lidhur me procesmbajtësen. Derisa pretendimet për konfliktin e interesit për ekspertin financiar mbeten të paqarta, ndaj edhe nuk është deklaruar, ndërsa lidhur me pretendimet e fundit për konfliktin e interesit, nëse A.B në cilësinë e dekanit të paditësit ka pasur apo jo të drejtë të lëshoj autorizim për iniciimin e procedurës dhe përfaqësim në çështjen kontestimore ndaj tani ankuesit, është çështje e cila do duhej të adresohet në ankesën e ushtruar ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Më tej gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se lidhur me pretendimet se në seancën gjyqësore të datës 27.10.2020 “gjyqtarja ka dal nga vetvetja dhe rëndë më ka fyer me fjalë “Marre për ty” si njeri akademik dhe profesor me titull akademik dhe shkencor”, ju informoj se tani ankuesi me 29.10.2020 duke u thirrur në po të njëjtat arsye ka parashtruar në gjykatë propozimin për përjashtimin e saj si gjyqtare e çështjes, e i cili propozim edhe i është refuzuar sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë AGJ.nr.391/2020 i datës 09.11.2020. Ashtu si kërkesën edhe Aktvendimin ankuesi ia ka bashkangjitur ankesës në fjalë.

Më tej, lidhur me pretendimet e fundit për konfliktin e interesit, nëse A.B në cilësinë e dekanit të paditësit ka pasur apo jo të drejtë të lëshoj autorizim për iniciimin e procedurës dhe përfaqësim në çështjen kontestimore ndaj tani ankuesit, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se kjo është çështje e cila do duhej të adresohet në ankesën e ushtruar ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa pretendimet për konfliktin e interesit për ekspertin financiar mbeten të paqarta, andaj nuk është deklaruar.

Në fund ka deklaruar se nga të lartë cekurat konsideroj se nuk kemi të bëjmë me shkeljen disiplinore.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për iniciim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës L.B.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Në hyrje të ankesës disiplinore, parashtruesi i ankesës ka përcaktuar se këtë ankesë e ka paraqitur kundër një gjykimi të njëanshëm me konflikt interesi, si dhe për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore, për shkak të konstatimit të gabuar a po jo të plotë a po vërtetimit të gjendjes faktike si dhe për shkak të shkeljes së procedura disiplinore.

Në lidhje me pretendimin për shkelje të dispozitave ligjore a po konstatim të gabuar a po jo të të vërtetimit të gjendjes faktike, Autoriteti Kompetent njofton parashtruesin e ankesës se Gjykata e shkallës së dytë e ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të ligjit.

Autoriteti Kompetent ka vlerësuar se aplikimi i gabuar dhe jo i drejtë i te drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtareve gjatë punës së tyre, mund të jete shkak për ushtrimin e ankesës nga ana e palës së pakënaqur në Gjykatën e instancës me të lartë, e që kjo çështje lidhet me aspektin profesional të gjyqtarit dhe e njëjta mund të shërbejë si kriter në vlerësimin e performancës së gjyqtarit të caktuar, por jo të konsiderohet shkelje disiplinore nga ana e të njëjtit.

Sa i përket pretendimit se gjyqtarja e çështjes dhe e autorizuar e palës paditëse av. T.B njihen edhe më herët, Autoriteti Kompetent nuk ka arritur të provojë pretendimet e palës ankuese në lidhje me këtë pasi që në këtë drejtim parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova për të argumentuar një fakt të tillë, ndërsa gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se të njëjtën nuk e njeh, nuk e ka të afërme dhe për herë të parë e ka takuar si avokate në seancat gjyqësore.

Ndërkaq, pretendimi në lidhje me mbajtjen e seancës gjyqësore nga ana e sekretares juridike S.C edhe pala e paditur/kundër paditësi ka kërkuar nga gjyqtarja që seanca të mos mbahet nga ana e të njëjtës për shkak se ka konflikt interesi sepse e njëjta është studente në kolegjin Juridica, në bazë të shkresave të lëndëve, respektivisht procesverbaleve gjyqësore nuk është gjetur asnjë kërkesë e tillë e parashtruar, por as edhe ndonjë vërejtje e dhënë nga ana e palëve në procedurë në lidhje me përbërjen e gjykatës.

Po ashtu, sa i përket pretendimit se gjyqtarja e çështjes e ka fyer parashtruesin e ankesës me “marre për ty si njeri akademik dhe profesor me titull akademik dhe shkencor”, pretendim ky i paraqitur nga parashtruesi i ankesës edhe në kërkesën e tij të datës 23.11.2020 për përjashtim të gjyqtarës L.B, kërkesë e refuzuar me Aktvendimin GJA.nr.391/20, Kryetarja e Gjykatës vlerëson se pretendimet e tilla janë shqyrtuar dhe si të tilla nuk mund të jenë objekt i shqyrtimit të serishëm. Ndërkaq, në procesverbalin gjyqësor të datës 27.10.2020 nuk konstatohet asnjë vërejtje e palës së paditur a po palëve në procedurë në lidhje me sjelljen e gjyqtarës, andaj për Kryetaren e Gjykatës si Autoritet Kompetent, mbetet i paprovuar një pretendim i tillë.

Autoriteti kompetent vë në pah se palët në procedurë, në çdo rast kur gjatë seancave gjyqësore nuk janë dakord me përbërjen e gjykatës a po edhe me udhëzimet e gjyqtarit të çështjes a po kanë dyshime në lidhje me sjelljet e të njëjtit, obligohen që të kërkojnë nga gjyqtari i çështjes që këto pretendime të konstatohen në procesverbal dhe të njëjtat të përdoren si prova për procedura të tjera si kërkesa për përjashtim a po procedura të tjera.

Sa i përket pretendimeve se gjyqtarja e çështjes nuk i ka ofruar siguri juridike palës së paditur/kundër paditësit pasi që në këtë çështje gjyqësore disa herë i ka shqiptuar vërejtje të autorizuarës së paditësit, njoftojmë parashtruesin e kërkesës se gjyqtarja e çështjes është e detyruar të kujdeset për zbatimin e akteve normative në mbajtjen e rendit në gjykatore dhe ruajtjen e dinjitetit të gjykatës. Kjo sepse, gjyqtari çdo herë duhet të kujdeset që procedura të

zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë. Andaj, nga të dhënat e lartshënuara gjyqtari i çështjes penale ka vepruar konform nenit 297 par.1 të KPPRK, duke i dhënë vërejtje avokatit në çdo rast kur ka konsideruar se një gjë e tillë duhet të bëhet.

Sa i përket pretendimeve për fyerje nga ana e përfaqësueses me autorizim drejtuar të paditurit/kundër paditësit, Autoriteti Kompetent vë në pah se avokatët mbikëqyren nga Oda e Avokatëve, andaj në lidhje me sjelljet e tyre, palët kanë të drejtë të shfrytëzimit të mekanizmave që parashihen me rregulloret në fuqi në kuadër të Odës së Avokatëve.

Pretendimet për keqinterpretim të provave materiale, a po konstatime të gabuara nga ana e gjyqtarës së çështjes, nuk mund të jenë arsye për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtaren e çështjes, kjo pasi që Autoriteti Kompetent – Kryetarja e Gjykatës nuk ka kompetencë të vlerësoj a po të komentoj vendimet gjyqësore.

Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ku parashihet: "Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit”.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/15/24, me datë 22.07.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë